



# Propozime për ndryshime shkollore për një shkollë më të barabartë në Trollhättan

**Të gjithë fëmijët dhe nxënësit kanë të drejtë në parakushte me vlera të njësojta për të arritur qëllimet në shkollë. Një shkollim i suksesshëm është një parakusht i rëndësishëm për çdo person për ta arritur suksesin e tij në jetë, për të marrë një punë, mbështetje dhe një jetë të mirë. Por në Trollhättan - ashtu si në shumë qytete të tjera - segregacioni nënkupton që fëmijët dhe nxënësit kanë mundësi të ndryshme për të pasur sukses, varësisht se në cilën pjesë të qytetit rriten ata, ose në cilën shkollë shkojnë.**

Në qershor 2019, politikanët në Këshillit të Arsimit ia dhanë një detyrë Administratës. Bëhej fjalë për atë që të gjendet një propozim i cili mund t'i zvogëlojë efektet e segregacionit shkollor dhe të krijohen kushte më të barasvlefshme për të gjithë fëmijët dhe nxënësit në Trollhättan. Administrata tani ka përcaktuar propozime për masa të tilla, por edhe propozime që do të thonë se më shumë nga burimet e shkollës mund të shkojnë në mësimdhënie, në vend të kostove për lokale. Propozimet mbështeten nga Ligji për shkollën, planet mësimore, qëllimet e Kuvendit të komunës dhe të Këshillit të Arsimit, si dhe nga Ideja Gjithëpërfshirëse e Administratës së Arsimit.

## **Propozimet të cilat nxjerren në pah në investigim janë si vijon:**

- Kronan klasa F - 9 shndërrohet në një shkollë F - 3 që nga gushti 2021. Gjithsej rreth 210 nxënësve të klasëve 4 - 9 u ofrohet vend në shkollat në Trollhättanin lindor dhe në Trollhättanin perëndimor (Lyrfågelskolan, Stavreskolan, Strömsslundsskolan, Paradisskolan, Skogshöjdens skola). Ndarjet bëhen sipas nevojave dhe parakushteve individuale të nxënësve, por edhe mundësive të shkollave për pranimin e nxënësve përveç atyre që tani më shkojnë në shkolla. Me transportim shkollor nxënësit vijnë në shkollën e re për rreth 20 - 25 minuta.
  - Propozimi do ta zvogëlonte segregacionin shkollor dhe do ta rriste përzjerjen e nxënësve në Trollhättan. Më shumë nxënës fitojnë mundësi për një shkollim ku shumë shokë e shoqe të klasës gjuhën suedeze e kanë gjuhë amtare.
- Fräsegårdsskolan klasa F - 6 mbyllet që nga gushti 2021. Rreth 110 nxënësve të klasëve F - 3 në radhë të parë u ofrohet vendi në Kronan, dhe rreth 60 nxënësve të klasëve 4 - 6 u ofrohen vende në Trollhättanin lindor dhe perëndimor (Lyrfågelskolan, Stavreskolan, Strömsslundsskolan, Paradisskolan, Skogshöjdens skola). Ndarjet bëhen sipas nevojave dhe parakushteve individuale të nxënësve, por edhe mundësive të shkollave për pranimin e nxënësve përveç atyre që tani më shkojnë në shkolla. Me transportim shkollor nxënësit vijnë në shkollën e re për rreth 20 - 25 minuta.

- Propozimi do ta zvogëlonte segregacionin shkollor dhe do ta rriste përzierjen e nxënësve në Trollhättan. Më shumë nxënës fitojnë mundësinë për një shkollim ku shumë shokë e shoqe të klasës gjuhën suedeze e kanë gjuhë amtare.
- Velanda skola F - 6 mbyllet nga gushti 2021. Rreth 130 nxënësve në radhë të parë u ofrohet vendi në Sylteskolan e re.
  - Velanda skola është një shkollë e vogël e cila ndodhet para shpenzimeve të larta për meremetim ose ndërtim të ri. Në Sylte skolan e re ka vend në lokale moderne dhe propozimi e bën të mundshme që përveç të tjerash, të zvogëlohen shpenzimet për lokale, në dobi të mësimin. Me transportim shkollor nxënësit vijnë në Sylteskolan për më pak se 15 minuta. Propozimi do ta zvogëlonte segregacionin shkollor dhe do ta rriste përzierjen e nxënësve në Trollhättan.
- Mirëseardhja (veprimtaria për të ardhurit e rinj) shpërngulet nga Lyrfågelskolan që nga gushti 2021.
  - Shpërngulja e bën të mundshme që Lyrfågelskolan të pranojë më shumë nxënës.
- Direktivat e reja për atë se si nxënësve u ofrohet vend në shkollat fillore komunale. Në radhë të parë është dëshira e kujdestarit ajo që drejton (zgjedhjen e shkollës), dhe e drejta e fëmijës që të shkojë në shkollë në një shkollë afër shtëpisë.
  - Ndryshimi në radhë të parë ndikon në nxënësit të cilët sot shkojnë në Kronan dhe Frälsegårdsskolan dhe kjo do të thotë se këtyre nxënësve mund t'u ofrohen vende në shkolla në pjesë të tjera të qytetit.
- Rregullat për transportim shkollor për nxënësit e klasëve 7 – 9 ndryshohen, ashtu që ata fitojnë të drejtën për transportim shkollor nëse largësia deri në shkollë është 3 kilometra ose më shumë. Më parë kërkohej që largësia të jetë së paku 4 kilometra.
- Një ndryshim i rregullave për vendosjen e fëmijëve në përkujdesi i cili e bën të mundur që më shumë fëmijëve t'u ofrohet më shumë kohë në parashkollorë, nëse zhvillimi i tyre gjuhësor ndihmohet nga kjo.
  - Ndhimesat e hershme janë të rëndësishme dhe për shumë fëmijë parashkollorja është vendi i vetëm ku ata e përdorin gjuhën suedeze.
- Administrata e Arsimit po e hulumton mundësinë që parashkollorja Stallet të shpërngulet në lokalet e Frälsegårdsskolan.
  - Lokalet e parashkollorës janë në gjendje të keqe. Një shpërngulje në lokalet e Frälsegårdsskolan do të mund të nënkuptonte se Administrata u shmangte shpenzimeve të larta për meremetim dhe ndërtim të ri.
- Administrata e Arsimit po e hulumton mundësinë që ta shpërngulë veprimtarinë e Hälltorpskolan në Strömslundsskolan F - 6 dhe ta lejojë parashkollorën Mioäpplet që t'i marrë këto lokale.
  - Hälltorpskolan është një shkollë shumë e vogël me rreth 100 nxënës, gjë që shkakton vështirësi në organizimin ekonomik dhe pedagogjik. Ka nevoja të shtuara për vende parashkollorë në këtë zonë dhe me lokale më të mëdha Mioäpplet mund të pranojë më shumë fëmijë.
- Administrata e Arsimit po e hulumton mundësinë që të vë në praktikë autobusin për parashkollorë si mundësi për ta rritur integrimin dhe ta zhvillojë pedagogjinë jashtë shtëpisë në komunë. Autobusët gjithashtu mund të bëjnë të mundur që në një mënyrë të shpejtë të dalin në shesh nevojat e vendeve në parashkollorë në një mënyrë fleksibile.

Administrata e Arsimit dëshiron ta hulumtojë propozimin i cili e bën të mundshëm për disa nxënës që të kenë më shumë kohë në institucionin e kohës së lirë. Arsyeja është se mësimi në institucionin e kohës së lirë do të mund t'u ndihmonte disa nxënësve në zhvillimin e gjuhës dhe zhvillimin e tyre social.

## Prejardhja e fëmijëve dhe e nxënësve ndikon në rezultat

Hulumtimet shkencore tregojnë se prejardhja socio ekonomike e nxënësve ka domethënie të madhe se si ata arrijnë t'i mbërrijnë qëllimet në shkollë. Nxënësit prindërit e të cilëve kanë shkollim të lartë dhe të ardhura të larta kanë më shumë sukses se nxënësit prindërit e të cilëve kanë shkollim të ulët

dhe të ardhura të ulëta. Studimet gjithashtu kanë treguar se nxënësit prindërit e të cilëve kanë shkollim të ulët dhe të ardhura të ulëta prapëseprapë mund të kenë sukses më të mirë nëse ata shkojnë në një shkollë ku shumica e nxënësve i kanë prindërit me shkollim të lartë dhe me të ardhura të larta.

## Shkolla në Trollhättan është në segregacion

Çdo i treti fëmijë në Trollhättan ka një prejardhje të huaj, por segregacioni në shkollë bën që përqindja e nxënësve me prejardhje të huaj afrohet 100% në disa shkolla të qytetit. Shkollat me një përqindje të lartë të nxënësve me prejardhje të huaj gjithashtu e kanë të vështirë të gjejnë mësues të kualifikuar. Në të njëjtën kohë, ka edhe shkolla të tjera ku pothuajse të gjithë nxënësit kanë një prejardhje suedeze, dhe prindër me arsim të lartë dhe të ardhura të larta. Sot, përqindja e mësuesve të kualifikuar është më e ulëta në shkollat me më shumë nxënës me nevoja më të mëdha.

## Ndihmesat po bëhen qysh tani, por prapë nuk ka përparime

Drejtoria e Arsimit ka punuar për shumë vite për të zvogëluar segregacionin në shkolla dhe për të rritur rezultatet e nxënësve. Ka pasur të bëjë me burimet financiare, më shumë personel, mbështetje nga Agjencia Kombëtare e Arsimit (Skolverket) dhe me investimet për trajnimin e personelit. Përkundër kësaj, rezultatet e nxënësve nuk janë rritur aq sa duhet.

## Një shkollë e barasvlefshme është kërkesë konform ligjit për shkollën

Në Ligjin për shkollën dhe planin mësikor për shkollën fillore dhe parashkolloren thuhet se arsimi duhet të jetë i barasvlefshëm dhe i përshtatur për parakushtet dhe nevojat e fëmijëve dhe të nxënësve. Shkolla gjithashtu ka një përgjegjësi të veçantë për fëmijët dhe nxënësit të cilët për arsye të ndryshme kanë vështirësi në arritjen e qëllimeve. Kjo do të thotë që komunat dhe shkollat duhet të punojnë në mënyra të ndryshme në ashtu që fëmijët dhe nxënësit me prejardhje dhe kushte të ndryshme të kenë mundësi të barasvlefshme për të arritur qëllimet dhe të kenë sukses në arsimimin e tyre.

## Barasvlerë e shtuar dhe njësi shkollore të qëndrueshme

Nëse propozimet zbatohen, barasvlefshmëria e arsimit në Trollhättan pritet të rritet dhe segregacioni i shkollës do të ulet. Më shumë nxënës me prejardhje të pafavorshme socio ekonomike dhe nxënës me prejardhje të huaj marrin një shkollim ku më shumë shokë të klasës kanë kushte të favorshme socio ekonomike dhe suedishten si gjuhë amtare, gjë që ndihmon që më shumë nxënës t'i arrijnë qëllimet në shkollë. Suprimimi i njëjësive shkollore me kushte veçanërisht të vështira dhe i njëjësive të vogla shkollore i jep administratës një mundësi të shtuar

për të organizuar në një mënyrë të qëndrueshme si të personelit e kompetencave, financave dhe pedagogjisë.

## Na mbetet shumë punë

Një shkollim i suksesshëm dhe arsimit i përfunduar rrisin mundësitë e ardhshme të njerëzve për një jetë të mirë me punë dhe jetesë, dhe kjo është e rëndësishme krejt Trollhättanin dhe të rinjtë që rriten në qytet të ndiejnë besim në të ardhmen dhe pjesëmarrje në komunitet.

Masat të cilat po propozohen tani nuk janë një zgjidhje përfundimtare për problematikën e segregacionit të shkollës dhe të barazvlerës në shkollat e Trollhättanit, por këto janë propozimet e nxjerra në pah në këtë investigim janë ato që Administrata i vlerëson se janë veçanërisht të rëndësishme.

## Çka ndodh tani?

Propozimet e ngritura këtu janë pikërisht propozime, dhe jo diçka që tashmë është vendosur. Politikanët në Këshillin e Arsimit janë ata që mund të marrin vendime. Është planifikuar që kjo të bëhet në mbledhjen e Këshillit të Arsimit, më 27 tetor. Atëherë politikanët mund të zgjedhin që të miratojnë një, disa ose të gjitha masat. Ata gjithashtu mund të zgjedhin të mos miratojnë asnjë prej propozimeve, ose Administratës së Arsimit t'i japin për detyrë të bëjë ndryshime në propozimet aktuale, për vendime më vonë në vjeshtë ose në dimër.

## Plani kohor deri te vendimi i Këshillit të Arsimit

- 18 gusht: Personeli në shkollë, parashkollore dhe në institucionin e kohës së lirë e merr informacionin për propozimet. Informacioni u dërgohet kujdestarëve dhe vihet në faqen e internetit të Trollhättanit: [www.trollhattan.se](http://www.trollhattan.se)
- 19 gusht: Nxënësi i marrin informacionet nga mësueset / mësuesit e vet.
- 27 tetor 2020 – Propozimi trajtohet nga Këshilli i Arsimit.

## Dialogu i qytetarëve

Ne me kënaqësi dëshirojmë t'i dëgjojmë mendimet dhe pikëpamjet e tua për propozimet që kemi prezantuar. Ne do të lëshojmë një ftesë të veçantë për një forum dialogu në fillim të shtatorit. Atëherë ti ke mundësi për të bërë pyetje në lidhje me propozimet. Për shkak të pandemisë koronare dhe rrezikut të përhapjes së infeksionit, ne nuk jemi në gjendje të ftojme takime me shumë pjesëmarrës. Prandaj ne jemi duke punuar për të gjetur mënyra të tjera, që me ndihmën e teknikës ta bëjmë dialogun.

Ti qysh tani mund ta dërgosh një pyetje ose një pikëpamje me e-post në: [utbildning@trollhattan.se](mailto:utbildning@trollhattan.se).

## Historiku i investigimit

Në qershor 2019, politikanët në Këshillin e Arsimit ua dhanë nëpunësve të Administratës detyrën që ta rishikojnë organizimin e shkollave komunale. Detyra ishte, veç të tjerash, për të zvogëluar numrin e shkollave komunale në mënyrë që të krijohen kushte më të mira për një shkollë më të barasvlefshme në Trollhättan. Drejtorja gjithashtu u ngarkua me detyrën që t'i rishikojë rregullat të cilat rregullojnë mënyrën se si bëhet zgjedhja e shkollave jokomunale dhe se si nxënësve që nuk bëjnë një zgjedhje të shkollës t'u ofrohet një vend në një shkollë.

Hulumtimet në këtë fushë dhe puna e komunave të tjera për të zvogëluar segregacionin në shkolla, tregojnë se ka shumë ndryshime që janë të mundshme për t'u zbatuar. Bashkimi i shkollave, ose mbyllja e shkollave, mund të ndikojë në jetën e përditshme të njerëzve dhe të ndryshojë mundësinë për të jetuar dhe punuar në një rreth ose në një komunitet. Prandaj, Administrata ka peshuar të mirat dhe të këqijat e secilit propozim dhe është përpjekur të gjejë masa që japin efekt të madh dhe janë të rëndësishme për t'u zbatuar për sa më shumë fëmijë dhe nxënës në Trollhättan që të kenë sukses më të mirë në shkollë.

## Lexo më shumë

Në investigimin e Drejtorisë së Arsimit secili propozim ka një motivacion dhe përshkrim më të gjatë të efekteve. Nëse ti dëshiron ta lexosh tërë investigimin, ai ndodhet për t'u shkarkuar në faqen e

internetit: [www.trollhattan.se/likvardigskola](http://www.trollhattan.se/likvardigskola).

Ne aty gjithashtu do ta tubojmë një listë me pyetjet dhe përgjigjet më të zakonshme. Ti mund të bëjshë pyetje për investigimin duke dërguar e-postë në [utbildning@trollhattan.se](mailto:utbildning@trollhattan.se).